



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 379 Akti**

**Nr. 432 Vendimi**  
**Tiranë, më 1.9.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 1.9.2021, në mjediset e punës të Komisionit, mori në shqyrtim bazuar në dokumentacionin e përcjellë, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Luan Lusha**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**OBJEKTI:** **Ndërprerje e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.**

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi mori në shqyrtim vendimin nr. 281, datë 6.7.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dëgjoi arsyetimin ligjor të relatores të çështjes Alma Faskaj, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Luan Lusha është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Lusha, duke krahasuar “Deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Lusha:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe ka dërguar një raport të vitit 2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Luan Lusha.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura

sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**6.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

**7.** Në datën 14.4.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, në datën 20.5.2020 deklaroi, përmes postës elektronike, se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

**8.** Në datën 20.5.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Lusha, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

**9.** Në datën 24.5.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda datës 10.6.2021.

**10.** Në datën 27.5.2021, subjekti konfirmoi nëpërmjet telefonit se është njohur me rezultatet e hetimit dhe u njoh me materialet e dosjes në datën 15.6.2021.

**11.** Subjekti njoftoi në rrugë elektronike se për shkak të gjendjes shëndetësore të rënduar pas kalimit të Covid-19 i është rekomanduar nga mjekët të punojë në mënyrë të reduktuar dhe është trajtuar me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë, nga data 30.4.2021 deri më 30.5.2021, si dhe vijonte të ishte me raport mjekësor nga data 22.5.2021 deri më 28.05.2021. Subjekti i bashkëlidh *e-mail*-it të dërguar në Komision raportet mjekësore për periudhat kohore respektive. Për sa më sipër, subjekti kërkoi afat më të gjatë në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tij lidhur me rezultatet e hetimi.

**12.** Komisioni iu drejtuar me shkresë institucioneve<sup>1</sup> kompetente në lidhje me gjendjen shëndetësore të subjektit të rivlerësimit, të cilat konfirmuan se subjekti ishte diagnostikuar me Covid-19.

**13.** Në zbatim germës “b”, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 “Mjetet e kërkimit të provës”, Komisioni çmoi të arsyeshme të thërriste<sup>2</sup>, në cilësinë e dëshmitarit, shtetasen Enada Bishtaja, mjeken e qendrës shëndetësore Kavajë, e cila kishte lëshuar raportet me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* për paaftësi të përkohshme në punë për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Lusha. Mjekja u njoftua me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2021, dhe dha dëshminë e saj në ambientet e

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 28.5.2021.

Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 28.5.2021.

<sup>2</sup> Shkresë nr\*\*\*prot., datë 28.5.2021.

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datën 2.6.2021, me anë të së cilës konfirmoi se në datën 14.3.2021 z. Luan Lusha kishte kryer testin e shpejtë dhe kishte rezultuar pozitiv me Covid-19. Së bashku me dëshminë e shtetasës E. B. Komisioni administroi edhe dosjen mjekësore të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Lusha, të vënë në dispozicion nga mjekja E.B. .

**14.** Referuar sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, Komisioni konstatoi se edhe pse subjekti ka paraqitur raporte mjekësorë për shkak të gjendjes shëndetësore, si dhe rekomandimit nga mjeku se duhet të punonte me kohë të reduktuar, ai ka vijuar ushtrimin e detyrës si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në shumë vendimmarrje përgjatë periudhës së raportit mjekësor.

**15.** Pas kërkesë së subjektit për të pasur më shumë kohë për dërgimin e pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit për shkak të gjendjes shëndetësore, Komisioni i komunikoi në rrugë elektronike subjektit afatin e ri të dërgimit të pretendimeve mbi rezultatet e hetimit brenda datës 14.6.2021.

**16.** Subjekti i rivlerësimit, në rrugë elektronike në datën 14.6.2021, komunikoi se afati prej 4 ditësh më shumë për dërgimin e pretendimeve në lidhje me rezultat e hetimit ishte sërish i pamjaftueshëm, duke argumentuar se dy prej tyre përkonin me pushim zyrtar. Gjithashtu argumentoi se gjendja e tij shëndetësore vijonte të ishte e njëjta dhe duhet të punonte në mënyrë të reduktuar.

**17.** Me vendimin nr. 3, datë 14.6.2021, “Për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit”, Komisioni vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Luan Lusha, në seancë dëgjimore, e cila do të zhvillohej në datën 18.6.2021, në orën 10:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0 (*underground*), Tiranë.

**18.** Komisioni, në datën 14.6.2021, i komunikoi në rrugë elektronike subjektit të rivlerësimit se pavarësisht mungesës së paraqitjes së dokumentacionit mbi të cilën mbështet kërkesën për shtyrje, gjithmonë në interes të procesit të rregullt ligjor, çmoi dhe i dha mundësinë që brenda datës 18.6.2021, datë në të cilën ishte caktuar për t’u zhvilluar seanca dëgjimore, të merrte në dorëzim materialet e dosjes dhe të depozitonte parashtrimet e tij.

**19.** Në datën 15.6.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

**20.** Më shkresën nr. \*\*\*prot., datë 16.6.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është informuar nga subjekti i rivlerësimit se në datën 15.6.2021 ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën e tij për dorëheqje. Me vendimin nr. 281, datë 6.7.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar kërkesën për dorëheqje të subjektit dhe me vendimin nr. 281, datë 6.7.2021, është vendosur: “*Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për z. Luan Lusha, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë*”.

**21.** Komisioni, me shkresë nr. \*\*\*, datë 17.6.2021, iu drejtua Këshillit të Lartë Gjyqësor për vënien në dispozicion të vendimit të mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit Luan Lusha. KLGJ-ja, me shkresë nr. \*\*\*prot., datë 22.6.2021, bën me dije se nuk janë shprehur ende me vendim në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit për z. Luan Lusha.

22. Në vijim, KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 9.7.2021, ka bërë me dije Komisionin se ka vendosur të pranojë kërkesën për dorëheqje, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit të z. Luan Lusha, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë, duke bashkëlidhur edhe vendimin nr. 281, datë 6.7.2021.

23. Referuar sa më sipër, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 22.7.2021, i ka kërkuar KLGJ-së informacion lidhur me depozitimin e mundshëm të ankimit të z. Luan Lusha të vendimit të sipërcituar, të marrë nga ky institucion.

24. Nisur nga sa më sipër, KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 27.7.2021, i ka kërkuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë informacion nëse z. Luan Lusha ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 281, datë 6.7.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

25. Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresë nr. \*\*\* prot datë 02.08.2021 informon Komisionin duke bashkëlidhur edhe kthim përgjigjen me nr\*\*\* prot datë 30.07.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, se ndaj vendimit nr. 281 datë 06.07.2021 “ Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin Luan Lusha” , deri në datën 29.07.2021 z.Luan Lusha nuk ka paraqitur ankim përpara Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

26. Komisioni ju drejtuar me shkresë nr. \*\*\* prot datë 22.07.2021 dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e cila ka informuar me shkresën nr. \*\*\* prot datë 28.07.2021 se ndaj vendimit nr. 281, datë 07.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë z. Luan Lusha nuk është ushtruar ankim, deri në datën 23.07.2021.

27. Subjekti në rrugë elektronike në datën 06.08.2021 depozitoi në Komision një kërkesë “Për ndërprerje të procesit të rivlerësimit” në përmbajtje të së cilës ndër të tjera ka cituar se “ Në datën 15.06.2021 kam paraqitur një kërkesë në Këshillin e Lartë Gjyqësor për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes dhe pas paraqitjes së kësaj kërkesë, me shkresën nr\*\*\* Prot, datë 08.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor më ka informuar lidhur me vendimin nr. 281, datë 06.07.2021 të këtij organi, përmes të cilit, Këshilli i Lartë Gjyqësor më ka miratuar kërkesën për dorëheqje, si dhe ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit. Duke qenë se jam dakord me këtë vendimmarrje të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pasojat e saj juridike, deklaroj se nuk do ta ankimoj atë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe si rrjedhojë, i kërkoj Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të ndërpresë procesin e rivlerësimit tim kalimtar.

## **ARSYETIMI I KOMISIONIT PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

### **a) Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

28. Kolegji i Posaçëm i Apelimit<sup>3</sup>, në lidhje me praktikat e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit të rivlerësimit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e

<sup>3</sup> Vendimi nr. 1/2018 JR, datë 11.6.2018, i KPA-së, paragrafët 96 dhe 97 të tij.

procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuar me ligj.

**29.** Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orienton që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

#### **b) Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit**

**30.** Në germën “a”, të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2012, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

**31.** Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

*“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para këshillit përkatës”.*

*2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.*

**32.** Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

**33.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësi subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të afatit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtë të japë dorëheqje dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.*

**34.** Më shkresën nr. \*\*\*prot., datë 28.7.2021, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka përcjellë në Komisionin informacionin se ndaj vendimit nr. 281, datë 6.7.2021, nuk është ushtruar ankimi gjyqësor.

**35.** Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara më lart, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit z. Luan Lusha, duhet të ndërpritet, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, pasi Komisioni nuk ka kompetenca për të vazhduar procesin e rivlerësimit, duke qenë se subjekti nuk bën më pjesë as në kategorinë e subjekteve që rivlerësohen *ex officio*, dhe as të atyre në mënyrë vullnetare, pasi nuk e ka statusin subjektiv, sipas pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës.

**36.** Për sa më sipër, bazuar në rrethanat e sipërcituara, si dhe në referim të germës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt rivlerësimi mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

**37.** Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja, e atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**38.** Ky është një qëndrim i unifikuar edhe i Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Lusha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Luan Lusha si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.9.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta Tafa (BUNGO)**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Anëtar**

**Alma FASKAJ**

**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*

*Denisa Kosta*